

Ku të informohem ?

Në internet, do të gjeni në faqet e Shërbimit të mbrojtjes së të rinjve, informacione plotësuese në lidhje me përkujdesjen për fëmijët gjatë ditës në gjirin familjar :

www.vd.ch/spj

Për t'u orientuar në faqet e internetit :

- « **Procedurat e autorizimit** për forma të ndryshme të përkujdesjes për fëmijët jashtë mjedisit familjar », më pas « **Përkujdesje në gjirin familjar për fëmijët gjatë ditës** ».
- « **Si të gjej një vend për t'u kujdesur për fëmijën tim gjatë ditës** » : kjo faqe përmban një lidhje me listën e strukturave koordinuese të përkujdesjes për fëmijët në gjirin familjar.
- « **Lidhjet** » : një faqe e plotë i është përkushtuar lidhjeve në lëminë e përkujdesjes për fëmijët gjatë ditës.

Mund ta kërkonti këtë doracak duke shkruar në adresën e mëposhtme :

Service de protection de la jeunesse


Office de surveillance des structures
d'accueil de mineurs
Av. Longemalle 1
1020 Renens

DFJC / SPJ - Septembre 2011 (version albanaise)

Për t'u bërë kujdestare për fëmijë në gjirin familjar : kujt duhet t'i drejtohem ?


Administrata e komunës ku banoni do t'ju tregojë cilës **strukturë koordinuese** të përkujdesjes për fëmijët gjatë ditës në mjedis familjar duhet t'i drejtoni lutjen tuaj.

Mundeni gjithashtu të lexoni në internet, faqet e Shërbimit të mbrojtjes së të rinjve (shihni në « Ku të informohem ? ») për të gjetur një listë të strukturave të koordinimit.



Kujdestare për fëmijë në gjirin familjar

Vula e komunës apo strukturës koordinuese që do t'u japë këtë doracak :



Département de la formation, de la jeunesse et de la culture
Service de protection de la jeunesse

Përkujdesja për fëmijë gjatë ditës në familje

Ligji i kantonit të vaudit për përkujdesjen për fëmijët gjatë ditës në familje (LAJE) ka hyrë në fuqi më 1 shtator 2006.

Ky ligj thotë që të gjithë personat që përkujdesen për fëmijë në banesat e tyre gjatë ditës përkundrejt një pagese, rregullisht e në mënyrë të vazhdueshme duhet të jenë të **autorizuar** dhe të bëjnë **pjesë** në një **strukturë koordinuese** të përkujdesjes për fëmijët gjatë ditës në mjedis familjar.

Autorizimet për këtë punë jepen nga komunat. Këto të fundit sigurojnë **mbikqyrjen** dhe **janë në kontakt të vazhdueshëm** me kujdestaret për fëmijë nëpërmjet strukturave koordinuese.

Kujdestare në gjirin familjar

Kujdestarja në gjirin familjar kujdeset për fëmijët në banesën e saj gjatë ditës.

Normalisht **ajo mund të kujdeset për pesë fëmijë maksimalisht**, përfshirë këtu edhe fëmijët e saj. Nganjëherë mund të bëhen edhe përjashtime.

Struktura koordinuese

Kjo strukturë planifikon kujdestarinë e fëmijëve në bazë të **nevojave të prindërve** dhe të **mundësive të kujdestareve**.

Ajo kujdeset edhe për aspektin financiar të këtij shërbimi (u fakturon prindërve dhe kryen pagesat e kujdestareve ditore).

Koordinatorja

Koordinatorja bën **një vlerësim** të kushteve në të cilat do të pritet në familje fëmija si edhe **kontrollon** cilësinë e punës së kujdestares për fëmijët që ka nën mbikqyrje.

Përparësitë e aktivitetit si kujdestare për fëmijët në familje

- Mund të **punoni në banesë** përkundrejt një pagesë e në të njëjtën kohë të kujdeseni edhe për fëmijët tuaj.
- Mund të bëni **një kontratë pune** dhe të jeni punonjëse e një strukture koordinuese.
- Kështu jeni **e punësuar zyrtarisht** e keni edhe një sigurim të përgjegjësisë qytetare.
- Përfitoni një **formacion falas**.
- Ushtroni një aktivitet **konformë ligjit**, i njohur dhe i dobishëm.

Kushtet për të marrë autorizimin

Kushtet kryesore për të marrë autorizimin janë si më poshtë :

- Të keni të paktën **moshën 20 vjeçare** e të jeni (e shëndetshme nga ana mendore) në gjendje të gjykoni;
- Të keni **përvojën** dhe **aftësitë edukative**, të domosdoshme, personale dhe shoqërore;
- Të keni ju dhe të gjithë anëtarët e familjes që jetojnë me ju **një gjendje shëndetësore fizike dhe psikike** që nuk bëhet pengesë në punën tuaj si kujdestare për fëmijët në banesë;

- Të keni një situatë personale dhe familjare që garanton **stabilitetin e këtij aktiviteti**;
- Të keni nacionalitetin zviceran apo një permi C, ose B apo çdo lloj tjetër leje qëndrimi të vlefshme të paktën për një vit;
- Të keni njohuri të mjaftueshme në gjuhën frënge;
- Të keni mundësi të bëni një **formacion fillestar** prej 25 orësh dhe një formacion të mëtejshëm;
- Nuk duhet të ushtroni një tjetër aktivitet i cili mund të dëmtojë **cilësinë e punës suaj si kujdestare për fëmijë në familje**.

Si duhet të veproni

- **Duhet të merrni kontakt me strukturën koordinuese** që drejton kujdestaret ditore për fëmijë në komunën ku banoni. (shihni faqen e pasme).
- **Të paraqiteni tek koordinatorja** e cila do t'ju informojë për veprimet që duhet të kryeni dhe dokumentat që duhet të dorëzoni. (veçanërisht një dokument që verteton që nuk jeni nën hetime, nuk keni probleme me drejtësinë dhe një certifikatë shëndetësore).

Me ta marrë kërkesën tuaj të shoqëruar nga dokumentat e nevojshme, koordinatorja do të vijë te ju në banesë për të bërë **një vlerësim shoqëror-edukativ**, në lidhje me cilësitë tuaja personale, aftësitë edukative dhe kushtet në të cilat do të kujdeseni për fëmijët në banesën tuaj.